



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:238058

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05633826

KPPP.nr.283/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rruga “Armend Daci” nr.1, Prishtinë, kundër debitorit “Gashi - AG” SH.P.K., me NUI:810406696, me seli në Pejë, fshati Rosujë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.270/22 të datës 26.10.2022, të Përmbartuesit Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, jashtë seancës me datën 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Gashi - AG” SH.P.K., i paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.270/22 i datës 26.10.2022, i Përmbartuesit Privat Jeton Krasniqi.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbartimor P.nr.270/22 i datës 26.10.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.270/22 të datës 26.10.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor Aktvendimit të Komisionit i Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.4919 të datës 26.11.2020, me të cilën është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës administrative shumë prej 5,038.76 €, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe bartjen e shumës përkatëse në

xhirollogarinë bankare të kreditorit, në të kundërtën përbarimi të realizohet me ndalim, sekuestrimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare duke përfshirë rrjedhën e interesit, regjistrimin, sekuestrimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se nuk ka qenë asnjëherë i njoftuar lidhur me detyrimin i cili kërkohet përmes procedurës përbarimore, kundër Aktvendimi për gjobë administrative nr.4949 të datës 26.11.2020, si dhe aktvendimit nr. K.A.127/2022 të datës 26.09.2022 me të cilin është refuzuar ankesa e debitorit, është iniciuar konflikti administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, andaj kemi të bëjmë me çështje paraprake pa zgjidhjen e të cilës nuk mund të vazhdohet procedura përbarimore dhe janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës përbarimore dhe pritjen e zgjidhjes së çështjes paraprake. Tutje ka shtuar se aktvendimi është i kundërligjshëm, për faktin se debitori nuk zhvillon fare aktivitete minerare që nga viti 2019, për shkak se të dy bashkëpronarët e saj janë me vendqëndrim në Gjermani. Sa i përket urdhrin përbarimor ka deklaruar se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa ta refuzoj urdhrin përbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se nuk ka qenë i njoftuar për detyrimin e tij ndaj kreditorit, pasi që i njëjti ka qenë i njoftuar me aktvendimin nr.4919 të datës 26.11.2020, ndaj të cilit ka ushtruar ankesë e cila është refuzuar me aktvendimin KA.nr.127/2022 të datës 26.09.2022. tutje ka shtuar se pretendimet e debitorit se aktvendimi është i kundërligjshëm, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi i kësaj procedure përbarimore, ndërsa sa i përket pretendimit se debitori ka ushtruar padi pranë gjykatës kompetente e njëjta nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktvendimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.4919 të datës 26.11.2020, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr.4919 i datës 26.11.2020, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.4919 i datës 26.11.2020, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.4919 i datës 26.11.2020, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është bërë i formës së prerë me datë 30.09.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 16.10.2022.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ, andaj kemi të bëjmë me çështje paraprake pa zgjidhjen e të cilës nuk mund të vazhdohet procedura përmbarimore dhe janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës përmbarimore dhe pritjen e zgjidhjes së çështjes paraprake, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore, ngase në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet

Administrative, është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*. Andaj fakti se debitori ka parashtruar padi nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.283/24, datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.